



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 15529/9986/5493 regj.themeltar

Nr. 2652 vendimi
Dt. 08.10.2019

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit me trup gjykues të përbërë nga:

Kryesuese: Alkelina Gazidedja
Anëtar: Amarildo Laçi
Anëtar: Bari Shyti

Asistuar nga sekretarja gjyqësore [REDACTED] sot më dt. 08.10.2019 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative me palë:

PADITËS: Ministria e Punëve të Brendshme.

E PADITUR: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

OBJEKTI:
-Konstatim i pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 34, datë 23.02.2016 të Komisionierit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
-Anulimin e Vendimit nr. 217, datë 30.12.2016 të Komisionierit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative". Neni 108 e vijues K.Pr.Administrative.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pasi ka marrë në shqyrtim çështjen me vendimin përfundimtar Nr. 2277 (80-2017-2311), datë 23.05.2017, ka vendosur:

- Rrëzimin e kërkesë - padisë.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, brenda 15 ditëve nga e nesërmeja e shpalljes.

Kundër vendimit ka bërë ankim pala paditëse, i cili kërkon ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë, duke parashtruar këto arsye:

- Ky vendim është në kundërshtim flagrant me ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, sepse vetë përkufizimi i termit diskriminim sipas përdorimit në dispozitivin e vendimit nga ana e komisionerit është i ndryshëm nga ai i përkufizuar në ligj.
- Komisioneri në vendimin e tij, të cilin e ka pasqyruar në kërkesën e bërë, duket se e ka të paqartë kuptimin e të “miturit subjekt shoqërimi dhe ndalimi” dhe të “miturit të cilët kanë prindërit apo kujdestarin ligjor” subjekt shoqërimi.
- Analiza që gjykata ka bërë në lidhje me afatin e ngritjes së padisë nuk gjen mbështetje ligjore sepse thelbi i vendimit është marrë në shkelje flagrante me ligjin gjë që e bënë vendimin absolutisht të pavlefshëm.
- Komisioneri me vendimin 217, datë 30.12.2016 vendosi:
 1. Ministria e Punëve të Brendshme, të gjobet me gjobë në vlerën 100.000 (njëqind) mijë lekë.
 2. Gjoha të derdhet në Buxhetin e Shtetit Brenda 30 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.
 3. Zbatimi i vendimit nr. 34, datë 23.02.2016 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi Brenda shtatë ditëve nga marrja dijani për sanksionet, sjell shfuqizimin e tyre.
- Rasti i të miturës objekt shqyrtimi i vendimit të sipërcituar, nuk përbën diskriminim të tërthortë të parashikuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
- Sipas kësaj dispozite “Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.
- Analogjia e përdorur në këtë rast, duke vendosur të miturën në pozicion të njëjtë me nënën e saj e cila ka qenë subjekt procedimi (e dyshuar për kryerjen e një veprë penale), nuk gjen zbatim për rastin konkret, pasi e mitura nuk ka qenë subjekt shoqërimi, duke u ndodhur kështu në një situatë të pakrahasueshme me atë të nënës së saj, me qëllim evidentimin e diskriminimit të tërthortë jo të konsumuar nga punonjësit e Policisë së Shtetit. Punonjësit e Policisë, duke marrë në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës, i ofruan znj. [REDAKTUAR] mundësi alternative për sistemimin e të miturës, gjatë kohës së shoqërimit të nënës së saj,

- duke i kërkuar që ta lërë pranë një të afërmi ose t'i vihej në dispozicion një psikolog, gjë që është refuzuar prej saj.
- Në pikën 2 të dispozitivit të vendimit sipërcituar, theksojmë se rregullat e trajtimit dhe shoqërimit për personat e mitur janë të parashikuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, në nenit 123 të tij dhe në aktet nënligjore që normojnë veprimtarinë e punonjësve të Policisë së Shtetit. Në veçanti, në pikën 6 të këtij neni, është parashikuar se “Punonjësi i Policisë bashkëpunon me qendrat e përkujdesjes sociale për të miturit, për ofrimin e asistencës së nevojshme ndaj të miturit”.
 - Gjithashtu, mënyra e trajtimit të të miturve nga punonjësit e policisë gjatë fazës së hetimeve paraprake, parashikohet në Urdhrin i Drejtorit të Policisë së Shtetit nr. 300, datë 08.07.2013, “Për miratimin e Procedurave Standarde të Punës “Për trajtimin e të miturve gjatë fazës së hetimeve paraprake”, ndërsa rregullat teknike të shoqërimit, mbajtjes dhe trajtimit të personave të mitur në ambientet e policisë, janë përcaktuar në Urdhrin e Drejtorit të Policisë së Shtetit nr. 678, datë 14.09.2015 “Për miratimin e rregullave teknike të shoqërimit në polici”.
 - Përsa më sipër Komisioneri kërkoj ti vihej në dispozicion kopje të Urdhrit të Drejtorit të policisë së Shtetit nr. 300, datë 08.07.2013 “Për miratimin e Procedurave Standarde të Punës për Trajtimin e të miturve gjatë fazës së hetimeve paraprake” dhe Urdhrin e Drejtorit të Policisë së Shtetit nr. 678, datë 14.09.2015 “Për miratimin e rregullimeve teknike të shoqërimit në polici.
 - Duke qënë se informacioni i kërkuar disponohet nga Drejtoria e Policisë së Shtetit e cila ka personalitet juridik publik dhe komisioneri i është drejtuar dhe ka mbajtur procesverbale në lidhje me situatën me këtë institucion, Ministria e Punëve të Brendshme i ka kërkuar zyrtarisht Drejtorisë së Policisë së Shtetit ti dërgoj informacionin e kërkuar, i cili i është dërguar Komisionerit. Parashikimet ligjore të sipërcituara, lidhur me procedurat që ndiqen nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit, për shoqërimin dhe ndalimin e të miturve, i referohen vetëm rasteve në të cilat i mituri ndodhet në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime. Por në thelbin e vendimit dhe konkretisht me konstatimin e diskriminimit të tërthorët është pikërisht fakti i trajtimit të një personi apo grup personash në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, gjë që nuk ka lidhje me situatën e krijuar.
 - Baza ligjore është pika 6 e nenit 123 i ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, parashikimi është i mjaftueshëm për rastin dhe situatën e krijuar. Thelbi i vendosjes së masës administrative nuk qëndron sepse nuk jemi para rastit të diskriminimit të tërthorët. Parashikimet ligjore ekzistojnë, ndërhyrja për ndryshimet dhe përmirësimet e legjislacionit lidhur me kushtet që duhet t’u krijohen, trajtimin dhe shoqërimin e personave të mitur nuk është e nevojshme.
 - Parashikimet ligjore për subjektet e rekomanduara ia kemi çuar zyrtarisht Komisionerit, brenda afatit të përcaktuar në vendim. Komisioneri duke iu referuar situatës konkrete, për mënyrën se si procedohet dhe për trajtimin e rasteve specifike ka arritur në konkluzion se nuk ekziston një parashikim ligjor apo procedure.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Pasi degjoi relatimin e çështjes nga gjyqtarja Alkelina Gazidedja dhe shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi,

VËREN

Se pranë Gjykatës Administrative të Apelit ka ardhur për gjykim çështja administrative me palë dhe objekt të sipërcituar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në bazë të ankimit të bërë nga pala paditëse.

Gjykata së pari, verifikoi ankimin e bërë nga pala paditëse nëse i plotëson kushtet e pranueshmërisë, fakt ky që është verifikuar me vendimin datë 06.06.2017, të gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë sipas kërkesave të nenit 46 - 48/2 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", konstatoi se ankimi i plotëson kushtet e pranueshmërisë.

Rrethanat e faktit

Nga aktet e ndodhura në dosjen objekt shqyrtimi në Gjykatën Administrative të Apelit mbi ankimin e palës paditëse rezulton se pala e paditur KMD ka nisur procedurat për verifikimin e ankesës së bërë nga shtetësja Natasha Nukshiqi ndaj veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë së Komisarariatit nr. 3 Tiranë. Nga përmbajtja e akteve rezulton se shtetësja [REDAKTUAR] ka pasur detyrime të prapambetura ndaj Shoqërisë OSHEE sh.a. Me datë 25.11.2014, përfaqësues të OSHEE-se kanë ndërprerë energjinë elektrike në banesën e saj, por për shkak të problemeve shëndetësore të vajzës së saj, shtetësja [REDAKTUAR] i ka rilidhur energjinë elektrike. Në këto kushte me datë 30.11.2014, përfaqësues të OSHEE-se, kanë njoftuar punonjësit e Policisë së Komisarariatit Nr. 3 Tiranë, të cilët kanë bërë shoqërimin e ankueses dhe vajzës së saj të mitur (5 vjeç), në ambientet e këtij Komisaritati.

Shtetësja [REDAKTUAR] është mbajtur e ndaluar për më shumë se 8 orë, së bashku me vajzën e saj, në një nga dhomat e shoqërimit, duke refuzuar t'i ofrohej ndihma mjekësore, psikologu, si dhe ushqimi.

Në këto kushte, shtetësja [REDAKTUAR] i është drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Bazuar në ankesën e shtetësës [REDAKTUAR], Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me shkresën nr. 386/1 prot, datë 13.06.2015 drejtuar Shefit të Komisarariatit të Policisë nr. 3, ka kërkuar informacion dhe parashtrime mbi pretendimet e subjektit ankues Natasha Nukshiqi.

Me datë 06.07.2015 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi kryhen Inspektim pranë Komisarariatit nr. 3, Tiranë lidhur me verifikimin e informacionit mbi ankesën e [REDAKTUAR]

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka vlerësuar se veprimet e kryera nga e punonjësve të Komisarariatit të Policisë nr. 3 Tiranë përbëjnë diskriminimit të tërthortë për shkak të moshës në fushën e të mirave materiale dhe shërbimeve të vajzës së mitur të ankueses [REDAKTUAR]

Në këto kushte, me vendimin nr. 34, datë 23.02.2016 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka vendosur: *“Konstatimin e diskriminimit të tërthortë për shkak të moshës në fushën e të mirave materiale dhe shërbimeve të vajzës së mitur znj. [REDAKTUAR] nga ana e punonjësve të Komisarariatit të Policisë nr. 3, Tiranë. Referuar pikës 1 të këtij vendimi rekomandohet marrja e masave të menjëhershme nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e ndryshimeve dhe përmirësimeve legislative lidhur me kushtet që duhet tu krijohen, trajtimin dhe shoqërimin e personave të mitur. Brenda 30 ditëve nga marrja dijëni për këtë vendim Ministria e Punëve të Brendshme të njoftojë Komisionierin lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi. Në referim të nenit 33 pika 11 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.1010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të pikës 13 të po këtij neni. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore”* Vendimi nr. 34, datë 23.02.2016 i është njoftuar palës së paditur me datë 31.03.2016.

Me shkresën nr. 1283, datë 21.04.2016 drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministria e Punëve të Brendshme ka konfirmuar se parashikimet ligjore për trajtimin dhe shoqërimin e personave të mitur ekzistojnë dhe se do të merren të gjitha masat e nevojshme për zbatimin me korrektësi dhe rigorizitet të parashikimeve ligjore dhe nënligjore ekzistuese nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit. Ministria e Brendshme ka informuar Komisionerit se problematika e ngritur prej tij për rregullim, sipas pikës 2 të vendimit nr. 34, datë 31.03.2016, është rregulluar me Urdhrin e Drejtorisë së Policisë së Shtetit nr. 300, datë 08.07.2013 “Për miratimin e Procedurave Standarde të Punës për Trajtimin e të Miturve gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe Urdhrit të Drejtorit të Policisë së Shtetit nr. 678, datë 14.09.2015 “Për miratimin e rregullave teknike të shoqërimit në polici”.

Me shkresën nr. 560, datë 24.05.2016 drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i ka kërkuar palës paditëse vënien në dispozicion të akteve të mësipërme.

Ka rezultuar se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka marrë përgjigje brenda afateve ligjore nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe bazuar në nenin 33 pika 11 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.1010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” me vendimin nr. 217, datë 30.12.2016 ka vendosur dënimim me gjobë në masën 100.000 lekë të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Zbatimi i vendimit nr. 34, datë 23.02.2016 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda shtate ditëve nga marrja dijëni për sanksionet sjell shfuqizimin e tyre.

Me shkresën nr. 01/1, datë 17.01.2017 Ministria e Punëve të Brendshme ka vënë në dispozicion të Komisionerit aktet e mësipërme dhe ka kërkuar shfuqizimin e sanksionit të vendosur nëpërmjet vendimit nr. 217, datë 30.12.2016.

Me shkresën nr. 32/1, datë 06.02.2017 drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Komisionieri ka sqaruar se parashikimet ligjore bashkëngjitur shkresës nr. 1/1, datë 17.01.2017 të Ministrisë së Brendshme i referohet vetëm rasteve në të cilat i mituri ndodhet në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime dhe që janë subjekt të procedimit penal dhe jo parashikime ligjore për shoqërimin dhe trajtimin e të miturve që nuk janë subjekt i procedimit penal. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka lënë në fuqi vendimin nr. 217, datë 30.12.2016, për dënimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme me gjobë në masën 100.000 lekë. Në këto kushte, pala paditëse i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadinë objekt gjykimi duke kërkuar sipas objektit të padisë si me sipër.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pasi ka marrë në shqyrtim çështjen me vendimin përfundimtar Nr. 2277 (80-2017-2311), datë 23.05.2017, ka vendosur:

- Rrëzimin e kërkesë - padisë.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes.

Gjykata ka arsyetuar se:

"...Gjykata pasi shqyrtoi në tërësi çështjen arriti në konkluzionin se kërkesë padia është e pambështetur në ligj dhe në prova dhe si e tillë ajo duhet rrëzuar.

Së pari, gjykata vlerëson se vendimi nr. 34, datë 23.02.2016 i Komisionierit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk përbën një akt administrative absolutisht të pavlefshëm.

Në lidhje me vendimi nr. 34, datë 23.02.2016 të Komisionierit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konform neneve 6 dhe 28 të K.Pr.Civile, gjykata do të marrë në shqyrtim vetëm pretendime të palës paditëse të cilat përfshihen në kuadrin e një pavlefshmërie absolute të aktit.

Konform nenit 115 të K.Pr.Administrative, akte administrative absolutisht të pavlefshme janë akte të nxjerra në kundërshtim flagrant me ligjin.

Konform nenit 116 të K.Pr.Administrative, aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, në rastet e mëposhtme a) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar; b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore; c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji.

Duke iu referuar rastit konkret, kjo gjykatë konstaton se vendimi nr. 34, datë 23.02.2016 i Komisionierit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është marrë nga një organ administrativ i

identifikuar, brenda kompetencave të tij ligjore dhe në përputhje me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji.

Kjo gjykatë vlerëson se nuk mund të marrë në shqyrtim pretendimet e palës paditëse në lidhje me faktin nëse veprimet e saj përbëjnë apo jo diskriminim të tërthortë. Kjo gjykatë vlerëson se pretendimet në lidhje me faktin nëse veprimet e palës paditëse përbëjnë apo jo diskriminim të tërthortë janë pretendime që kanë të bëjnë me themelin e vendimmarrjes së palës së paditur, të cilat nuk hyjnë në kuadrin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrative.

Kjo gjykatë vlerëson se përderisa pala paditëse nuk e ka kundërshtuar vendimin nr. 34, datë 23.02.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda afateve ligjore, atëherë ky vendim është i pakundërshtueshëm dhe gjykata nuk mundet që të vlerësojë nëse veprimet e palës paditëse përbëjnë apo jo diskriminim të tërthortë. Konkluzionet e arritura nga Komisioneri në vendimin nr. 34, datë 23.02.2016 janë të pakundërshtueshme dhe duhet të zbatohen nga palës të cilës i drejtohen.

Së dyti, gjykata gjithashtu e gjen të drejtë dhe të bazuar edhe vendimin nr. 217, datë 30.12.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për gjobitjen Ministri e Punëve të Brendshme të gjobitet me gjobë në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë. Ky vendim i palës së paditur është marrë pasi pala paditëse nuk ka marrë masat konkrete për ndreqjen e pasojave të ardhura si pasojë e diskriminimit. Me vendimin nr. 34, datë 23.02.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është rekomanduar marrja e masave të menjëhershme për kryerjen e ndryshimeve dhe përmirësimeve legjislative lidhur me kushtet që duhet të krijohen për trajtimin dhe shoqërimin e personave të mitur dhe njëkohësisht informimi i Komisionerit brenda 30 ditëve nga marrja dijeni lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.

Konform nenit 33 pika 11 e ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", nëse komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.

Në rastin konkret, me vendimin nr. 34, datë 23.02.2016 Komisioneri ka vlerësuar se pala paditëse duhet të marrë masa për kryerjen e ndryshimeve dhe përmirësimeve legjislative lidhur me kushtet që duhet tu krijohen, trajtimin dhe shoqërimin e personave të mitur, të cilët nuk janë persona nën hetim.

Siç u argumentua me lart, konkluzionet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të arritura në vendimin nr. 34, datë 23.02.2016 nuk mund të vihen në diskutim nga palët sepse kanë kaluar afatet për kundërshtimin e këtij vendimi.

Referuar Urdhrit të Drejtorisë së Policisë së Shtetit nr. 300, datë 08.07.2013 "Për miratimin e Procedurave Standarde të Punës për Trajtimin e të Miturve gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe Urdhrit të Drejtorit të Policisë së Shtetit nr. 678, datë 14.09.2015 "Për miratimin e rregullave teknike të shoqërimit në polici", rezulton se këto akte nuk i referohen trajtimit dhe shoqërimit të personave të mitur, të cilët nuk janë persona nën hetim. Për këto arsye, gjykata çmon se vendimi i Komisionerit për të dënuar Ministrinë e Punëve të Brendshme me gjobë në masën 100.000 lekë është i drejtë dhe i bazuar".

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala paditëse, e cila kërkon ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë, për shkaket e cituara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Vlerësimi i kolegjit administrativ të apelit

Kolegji Administrativ i Apelit konstaton se objekt shqyrtimi janë dy vendime të marra nga i padituri Komisioneri i Mbrojtjes nga Diskriminimi, konkretisht ai me nr. 34 datë 23.02.2016 i cili ka vendosur:

- *Konstatimin e diskriminimit të tërthortë, për shkak të moshës, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, të vajzës së mitur të znj. [REDAKTUAR] nga ana e punonjësve të Komisarariatit të Policisë Nr. 3, Tiranë.*
- *Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, rekomandohet marrja e masave të menjëherëshme nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, për kryerjen e ndryshimeve dhe përmirësimeve legjislative, lidhur me kushtet që duhet t'u krijohen, trajtimin dhe shoqërimin e personave të mitur.*
- *Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijëni për këtë vendim, Ministria e Punëve të Brendshme, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.*
- *Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010. "Për mbrojtjen nga diskriminimi", moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.*
- *Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.*
- *Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

dhe vendimi nr. 217 datë 30.12.2016 i cili ka vendosur :

- *Ministria e Punëve të Brendshme, të gjobitet me gjobë në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë.*
- *Gjoha të derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda 30 ditëve nga manja dijëni e këtij vendimi. Pagesa e kësaj vlere të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001,*

Entiteti i Qeverisjes: 1, Distrikti (TDO), Llogaria ekonomike: 7115499.

- Zbatimi i vendimit nr. 34, datë 23.02.2016 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda shtatë ditëve nga manja dijeni për sanksionet, sjell shfuqizimin e tyre.
- Subjekti, Ministria e Punëve të Brendshme, duhet të njoftojë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përputhje me sa parashikohet në pikën 3, të këtij vendimi.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

nga analiza e përmbajtjes së vendimeve objekt shqyrtimi në apel konstatohet se vendimi nr, 217 datë 30.12.2016 është dënim me gjobë në vlerën 100000 lekë, ndodhur në këto kushte, Kolegji administrativ i apelit çmon se ka pengesë ligjore për t'u shprehur në lidhje me ankimin e palës paditëse pasi ndaj këtij vendimi nuk mund të ushtrohet ankim, me pasojë mospranimin e ankimit për sa më poshtë vijon:

Neni 45 i ligjit nr. 49/2012 parashikon:

Vendime të paankimueshme

Nuk lejohet ankim ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt:

a) kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

b) kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

c) kundërshtimin e aktit administrativ që ka refuzuar dhënien e detyrimit në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

ç) mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi.

Neni 48 i ligjit nr 49/2012 parashikon :

Ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit

- 1. Gjykata, ku është paraqitur ankimi, dërgon ankimin, së bashku me aktet që i bashkëlidhen atij, vendimin e gjyqtarit për pranimin e ankimit, aktet e komunikimit të ankimit, si dhe dosjen e gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.*

Neni 50 i ligjit nr 49/2012 parashikon :

Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit në dhomë këshillimi

Gjykata Administrative e Apelit në dhomë këshillimi vendos:

a) mospranimin e ankimit, në rastet kur ankimi nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë dhe gjykata administrative e shkallës së parë nuk e ka bërë një gjë të tillë;

Nga aktet ne dosje rezulton se mosmarrëveshja objekt shqyrtimi lidhet me kundërshtimin e vendimit nr 217 datë 30.12.2016 i cili përban dënim me gjobë në masën 100000 lekë ndaj paditësit.

Pra akti administrative vendimi nr. 217 datë 30.12.2016 që kërkon paditësi të shfuqizohet në rastin konkret ka vlerë 100000 leke pra më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi, për rrjedhojë nga analiza e dispozitave të mësipërme dhe vlerës së aktit objekt gjykimi ndaj këtij vendimi gjyqësor **gjykata nuk duhej të lejonte ushtrimin e ankimit, gjithashtu gjyqtari që ka verifikuar kushtet e pranueshmërisë së ankimit nuk duhej të kishte vendosur pranimin e ankimit** por për sa kohë ky vendim nuk është marrë nga gjykata administrative e shkallës së parë, është kolegji administrativ i apelit i cili vendos mospranimin e ankimit pasi ankimi i palës paditëse ndaj vendimit gjyqësor nr. 2277, datë 23.05.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë , në lidhje me disponimin pasi nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë për shkak të vlerës nën njëzetfish të pagës minimale në shkallë vendi të aktit administrativ, vendimit nr. 217 datë 30.12.2016 për të cilin kërkohet shfuqizimi, objekt gjykimi. Në lidhje me këtë disponim nuk lejohet rekurs.

Në lidhje me disponimin e gjykatës për rrëzimin e padisë për vendimin nr. 34 datë 23.02.2016 të nxjerrë nga i padituri KMD kolegji vlerëson se gjykata me të drejtë ka vendosur rrëzimin e padisë ndaj nuk ka vend për ndryshimin e vendimit objekt ankimi. Kolegji Administrativ i Apelit arrin në këtë përfundim duke pasur parasysh këto konsiderata:

Në analizë të përmbajtjes së akteve procedurale të procesit në shkallë të parë dhe ankimit, Kolegji Administrativ i Apelit, konkludoi se duhet të vlerësojë themelin e çështjes pasi çmon se procesi gjyqësor dhe dhënia e vendimit përfundimtar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë respekton normat e procesit të rregullt ligjor dhe, nuk konstatoi, qoftë edhe kryesisht, ndonjë shkelje të ligjit procedural në gjykimin e çështjes nga gjykata e shkallës së parë, me pasojë pavlefshmërinë e procesit dhe/ose vendimit gjyqësor apo të tilla që kanë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimit të ankimuar.

Kolegji vlerëson se paditësi gëzon legjitimitimin real e procedural të ngritjes së padisë kundrejt palës së paditur, sipas nenit 15/a të ligjit nr. 49/2012, në të cilin është përcaktuar se të drejtën e padisë në gjykatën administrative e ka çdo subjekt, që pretendon se i është cenuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik.

Nga aktet e gjykimit të çështjes në shkallë të parë administrative rezulton se objekti i gjykimit

është i lidhur me aktin administrative të palës së paditur, që e ngarkojnë me detyrime palën paditëse.

Kolegji Administrativ i Apelit, në analizë të shkakut dhe kërkimit objekt padie, pretendimeve të palëve dhe provave shkresore të lejuara për shqyrtim në lidhje me këtë mosmarrëveshje, çmon se vendimi nr. 2277 datë 23.05.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duhet të lihet në fuqi.

Në shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve administrative objekt gjykimi në kontekstet me pretendimet e ngritura në ankim, Gjykata Administrative e Apelit i referohet parimit procedural të gjykimit administrativ të sanksionuar në nenin 37, pika 1 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, parim sipas të cilit gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ.

Mbi bazën e kërkimeve të materializuara në objektin e padisë, pretendimeve të ngritura gjatë gjykimit në shkallë të parë, duke referuar bazës juridike të padisë dhe shkaqeve të ngritura në ankim, rezulton se pala paditëse e ka orientuar shqyrtimin gjyqësor në analizën e ekzistencës ose jo të shkaqeve të pavlefshmërisë absolute të aktit administrative objekt gjykimi, në kuptim të nenit 116 të Kodit të Procedurave Administrative.

Në trajtimin doktrinar, aktet administrative absolutisht të pavlefshme për shkak të shkeljes thelbësore të ligjeve nuk e kanë fuqinë juridike të një akti të vlefshëm dhe objektivisht konsiderohet se nuk kanë ekzistuar për asnjë çast. Akti që në momentin e nxjerrjes nuk krijon dhe as mund të krijojë pasojat juridike përse është nxjerrë dhe ai është një nulitet që nuk ka hyrë kurrë në fuqi. Një akti i tillë konsiderohet se nuk ka fuqi detyruese ndaj personave apo subjekteve, të cilëve ju drejtohet, dhe si rrjedhojë këta mund të refuzojnë drejtpërdrejt plotësimin e detyrimeve apo urdhërimeve që rrjedhin nga akti, pa qenë nevoja që për pavlefshmërinë të shprehet patjetër ndonjë organ shtetëror. Pavlefshmëria absolute e aktit administrativ është e lidhur me shkelje flagrante, lehtësisht të kuptueshme të ligjit material ose atij procedural. Pavlefshmëria absolute e aktit sipas nenit 116/a të Kodit të Procedurave Administrative, ndodhte kur organi administrativ është i paidentifikuar ose nuk njihet si i tillë. Që një organ të konsiderohet i njohur nga ligji, ai duhet të jetë i pajisur me tagra pushteti, të jetë kompetent për veprimtarinë administrative dhe të jetë i njohur nga ligji për kryerjen e një veprimtarie të tillë. Në kuptim të germës “b” të nenit 116 të këtij Kodi, akti administrativ do të quhej absolutisht i pavlefshëm kur organi administrativ merr dhe ushtron kompetencat e një organi tjetër administrativ ose kur vepron në kapërcim të kompetencave të tij ligjore. Në kuptim të germës “c” të nenit 116 të këtij Kodi, situata e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ i cili është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e parashikuar nga ligji, lidhej me situatën e rëndë të shkeljes së ligjit në mënyrë flagrante kuptimi i së cilës referon në domosdoshmërinë e respektimit të procedurës në atë masë, sa mosrespektimi i saj do të prodhonte një akt në vlerësim të gabuar të ligjit. Jo të gjitha shkeljet që lidhen me procedurën dhe formën mund të çojnë

detyrimisht në pavlefshmërinë e aktit. Një përcaktim i tillë ka gjetur pasqyrim edhe në nenin 40, pika 4 të ligjit nr. 49/2012.

Në një vlerësim të drejtë të rrethanave të faktit dhe të ligjit, Kolegji vlerëson se me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka konkluduar se duke iu referuar nenit 116 të Kodit të Procedurave Administrative arrihet në përfundimin se në nxjerrjen e vendimeve objekt gjykimi nuk konkurren asnjë nga shkaqet e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ.

Nëse pala e paditur në nxjerrjen e aktit administrative objekt gjykimi ka vepruar në kundërshtim me ligjin kjo është një çështje që lidhet me pavlefshmërinë relative të aktit, të cilën gjykata nuk e ka objekt të shqyrtimit gjyqësor, në bazë të parimit procedural të sanksionuar në nenin 6 të Kodit të Procedurës Civile, për pasojë pretendimet e ngritura në ankim se në rastin konkret nuk jemi përpara diskriminimit të tërthortë për shkak të moshës të të miturës në rastin konkret nuk mund të merret në analizë nga ky kolegji pasi kjo është çështje e shqyrtimit dhe kontrollit të ligjshmërisë së aktit dhe jo konstatimit të pavlefshmërisë absolute të tij.

Bazuar në ankesën e shtetases Natasha Nokshiqi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me shkresën nr. 386/1 prot., datë 13.06.2015 drejtuar Shefit të Komisaritit të Policisë nr. 3, ka kërkuar informacion dhe parashtrime mbi pretendimet e subjektit ankues Natasha Nokshiqi.

Me datë 06.07.2015 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi kryhen Inspektim pranë Komisaritit nr.3, Tiranë lidhur me verifikimin e informacionit mbi ankesën e [REDACTED]

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka vlerësuar se veprimet e kryera nga e punonjësve të Komisaritit të Policisë nr. 3 Tiranë përbëjnë diskriminimit të tërthortë për shkak të moshës në fushën e të mirave materiale dhe shërbimeve të vajzës së mitur të ankueses [REDACTED]

Në këto kushte, me vendimin nr. 34, datë 23.02.2016 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka vendosur: *“Konstatimin e diskriminimit të tërthortë për shkak të moshës në fushën e të mirave materiale dhe shërbimeve të vajzës së mitur znj. [REDACTED] nga ana e punonjësve të Komisaritit të Policisë nr. 3, Tiranë. Referuar pikës 1 të këtij vendimi rekomandohet marrja e masave të menjëhershme nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e ndryshimeve dhe përmirësimeve legislative lidhur me kushtet që duhet tu krijohen, trajtimin dhe shoqërimin e personave të mitur. Brenda 30 ditëve nga marrja dijani për këtë vendim Ministria e Punëve të Brendshme të njoftojë Komisionierin lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi. Në referim të nenit 33 pika 11 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.1010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të pikës 13 të po këtij neni. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore”* Vendimi nr. 34, datë 23.02.2016 i është njoftuar palës së paditur me datë 31.03.2016.

Me shkresën nr. 1283, datë 21.04.2016 drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministria e Punëve të Brendshme ka konfirmuar se parashikimet ligjore për trajtimin dhe

shoqërimin e personave të mitur ekzistojnë dhe se do të merren të gjitha masat e nevojshme për zbatimin me korrektësi dhe rigorizitet të parashikimeve ligjore dhe nënligjore ekzistuese nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit. Ministria e Brendshme ka informuar Komisionerin se problematika e ngritur prej tij për rregullim, sipas pikës 2 të vendimit nr. 34, datë 31.03.2016, është rregulluar me Urdhrin e Drejtorisë së Policisë së Shtetit nr. 300, datë 08.07.2013 “Për miratimin e Procedurave Standarde të Punës për Trajtimin e të Miturve gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe Urdhrit të Drejtorit të Policisë së Shtetit nr. 678, datë 14.09.2015 “Për miratimin e rregullave teknike të shoqërimit në polici”.

Me shkresën nr. 560, datë 24.05.2016 drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i ka kërkuar palës paditëse vënien në dispozicion të akteve të mësipërme.

Ka rezultuar se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka marrë përgjigje brenda afateve ligjore nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe bazuar në nenin 33 pika 11 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” me vendimin nr. 217, datë 30.12.2016 ka vendosur dënimim me gjobë në masën 100.000 lekë të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Zbatimi i vendimit nr. 34, datë 23.02.2016 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda shtate ditëve nga marrja dijeni për sanksionet sjell shfuqizimin e tyre.

Me shkresën nr. 01/1, datë 17.01.2017 Ministria e Punëve të Brendshme ka vënë në dispozicion të Komisionerit aktet e mësipërme dhe ka kërkuar shfuqizimin e sanksionit të vendosur nëpërmjet vendimit nr. 217, datë 30.12.2016.

Me shkresën nr. 32/1, datë 06.02.2017 drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Komisioneri ka sqaruar se parashikimet ligjore bashkëngjitur shkresës nr. 1/1, datë 17.01.2017 të Ministrisë së Brendshme i referohet vetëm rasteve në të cilat i mituri ndodhet në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime dhe që janë subjekt të procedimit penal dhe jo parashikime ligjore për shoqërimin dhe trajtimin e të miturve që nuk janë subjekt i procedimit penal. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka lënë në fuqi vendimin nr. 217, datë 30.12.2016, për dënimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme me gjobë në masën 100.000 lekë.

Nga analiza e provave të sipër cituara dhe ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” kolegji vlerëson se në rastin konkret akti administrativ objekt gjykimi është nxjerrë nga organ i identifikuar-KMD, brenda kompetencave të tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi, mbi bazën e ankimit të bërë nga nëna e të miturës dhe pas kryerjes së procedurave të kërkuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” për të cilat as në ankim pala paditëse nuk ka parashtruar shkaqe ankimore.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në Nenin 50/a/b të Ligjit Nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

VENDOSI:

- Mospranimin e ankimit të palës paditëse ndaj vendimit nr. 2277 dt. 23.05.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, përsa i përket vendimit nr. 217 dt. 30.12.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs.
- Lënien në fuqi të vendimit nr. 2277 dt. 23.05.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, përsa i përket rrëzimit të vendimit nr.34 dt. 23.02.2016, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë, brenda 30 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall sot më 08.10.2019 në Tiranë.

ANËTAR	ANËTAR	KRYESUESE
Amarildo LAÇI d.v	Bari SHYTI d.v	Alkelina GAZIDEDJA d.v

Vërtetohet njësia me origjinalin

KANCELAR

*Kancelari
Levanat Stevitaj
Aratay*